Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

GJURMA MUJORE

Shkurt 2026

Ekspozitë Studentore "Restaurimi i Banesave në Gjirokastër"

Inspektim në Kishën e Shën Kollit, Krutje e Sipërme, Lushnjë

Inspektim i detajuar në Kalanë e Gjirokastrës

Inspektim në terren,Shkodër

Vizitë dokumentuese, Kisha e Shën Premtes, Kavajë

Botimi nr. 02

IKTK ushtron rapresentimi në fushën e trashëgimisë kulturore materiale dhe shtesë/jo, duke përfshirë ndërtesa, ansamble, sheshe/rrethina historike, monumente arkeologjike dhe punimeve e saj, si dhe kontrollon e procedurat të shoqërojnë përmirësimet dhe të kryhemi në Republikën e Shqipërisë.

Ekspozitë Studentore "Restaurimi i Banesave në Gjirokastër"


Universiteti POLIS, me mbështetjen teknike të IKTK-së dhe DRTK Gjirokastër, prezanton këtë ekspozitë si rezultat të një procesi të mirëfilltë akademik dhe si një model bashkëpunimi institucional në funksion të mbrojtjes, dokumentimit dhe zhvillimit të trashëgimisë kulturore të Gjirokastrës.





Projekti nisi me fazën e rilevimit dhe dokumentimit në terren të 12 banesave dhe objekteve me vlerë të veçantë historike në qytet. Mbi këtë bazë, studentët zhvilluan analiza të thelluara arkitektonike dhe konstruktive, duke hartuar propozime konkrete për restaurim, konsolidim strukturor dhe ri-jetëzim funksional të këtyre objekteve, si pjesë integrale e Trashëgimisë Kulturore Kombëtare.

Ekspozita paraqet jo vetëm vizione projektuale, por edhe një qasje të përgjegjshme profesionale ndaj ruajtjes së autenticitetit dhe identitetit urban të Gjirokastrës.



Inspektim në Kishën e Shën Kollit, Krutje e Sipërme, Lushnjë

Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), në kuadër të punës së përditshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore , si dhe në përgjigje të interesit të shtuar të Bashkisë Lushnjë, realizoi një inspektim në pasurinë kulturore Kisha e Shën Kollit, Krutje e Sipërme , me qëllim evidentimin e gjendjes aktuale të monumentit me viera të veçanta historike dhe arkitektonike.

Gjatë inspektimit u verifikua gjendja konstruktive e objektit, dëmtimet e konstatuara ndër vite dhe faktorët që ndikojnë në degradimin e tij . Ky proces synon rishikimin e projektit të restaurimit në përputhje me gjendjen reale dhe standardet bashkëkohore të konservimit.





Inspektim i detajuar në Kalanë e Gjirokastrës

Inspektimi i detajuar në Kalanë e Gjirokastrës
Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), në bashkëpunim me Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore DRTK Gjirokastër, zhvilloi një inspektim të detajuar në Kalanë e Gjirokastrës, me qëllim evidentimin e gjendjes aktuale të kësaj pasurie të rëndësishme kulturore.

Gjatë inspektimit në terren u krye verifikimi i gjendjes konservuese të strukturave fortifikuese, ambientëve të brendshme, elementëve arkitektonikë, si dhe u evidentuan problematikat që lidhen me degradimin e materialeve, dëmtimet strukturore dhe nevojat për ndërhyrje emergjente dhe afatgjata.





Inspektim në terren,Shkodër





Në vijim të angazhimit për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, u realizua një inspektim në terren në Banesa e Mati Jubanit (Monument Kulture, Kategoria I), në Shkodër, nga specialistët e Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore (IKTK), në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe përfaqësues të Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër. Vizita kishte për qëllim vlerësimin e gjendjes aktuale fizike të objektit, evidentimin e problematikave, si dhe përcaktimin e ndërhyrjeve prioritare në funksion të hartimit të projektit të restaurimit.



Vizitë dokumentuese, Kisha e Shën Premtes, Kavajë

Në kuadër të monitorimeve në terren, u realizua një vizitë dokumentuese në Kishën e Shën Premtes - Kavajë. Ky monument përfaqëson një nga objektet më të hershme të trashëgimisë kulturore në Shqipëri dhe është njëkohësisht edhe një dëshmon zhvillimin historik të arkitekturës së kulit në këtë zonë.

E ndërtuar në stilin gotiko-romanik, kisha shquhet për elementet e saj arkitektonike karakteristike dhe për afresket me vlera të veçanta artistike dhe historike, të cilat kanë arritur të ruhen përgjatë shekujve, duke përbërë një dëshmi të rëndësishme të trashëgimisë kulturore të zonës.



